




Republika e Kosovës

Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Direkcija za Poljoprivredu, Šumarstvo i Ruralni Razvoj
Department of Agriculture, Forestry and Rural Development

PLANI I PUNËS

(VITI 2026)

Misioni:

Misioni i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBPZHR) ka për objektivë udhëheqjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe konkurrues, i fokusuar në trajnimin dhe mbështetjen e fermerëve në Komunën e Skenderaj.

Vizioni:

Vizioni ynë është puna e përgjegjshme duke përdorur aftësitë profesionale dhe shkencore në mënyrë që të zhvillojmë sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.



Vlora Gucati- Salihu

E autorizuar për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Komuna Skenderaj

Tel: +383 (0) 38/200-42-738

Mob: +383 (0) 44-627-513

E-mail: vlora.gucati@rks-gov.net

Adresa: Rruga "28 Nëntori" Skenderaj.

Skenderaj, 17 Dhjetor 2025

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBPZHR) në kuadër të kompetencave, autorizimeve dhe përgjegjësi të saja në funksion të zbatimit të drejtpërdrejt të ligjeve:

- ✓ Ligjin për tokën bujqësore Nr.02/L-26;
- ✓ Ligjin për mbrojtjen e bimëve Nr.04/L-120;
- ✓ Ligjin për gjueti Nr.02/L-53;
- ✓ Ligjin për bletari Nr.02/L-111;

- ✓ Ligjin 03/L-153 për plotësim-ndryshimin e Ligjit për pyjet dhe udhëzimet administrative, në mbështetje të dispozitave të nenit 17 shkronja a,b,c, të Ligjit për vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040, si dhe dispozitat e statutit të Komunës së Skenderajt (neni 11, paragrafi 2, pika 3) Nr.01-013/491 si dhe mbështetur në rregulloren Komunale për menaxhimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e tokës bujqësore, mbrojtjen e bimëve, përkujdesjen ndaj kafshëve, mbrojtjen e faunës së egër dhe bletarinë.

DBPZHR ushtron këto veprimtari dhe obligime:

1. Në bashkëpunim, koordinim me Ministrinë për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural (MBPZHR) dhe Institucionet tjera ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna e Skenderajt në lëminë e bujqësisë, pylltarisë, resurset natyrore dhe zhvillimit rural.
2. Përcjell legjislacionin në fuqi dhe zbaton të njëjtin në lëminë e bujqësisë duke përfshirë prodhimtarinë bimore, blegtorale, resurset natyrore (faunën e egër) dhe zhvillimin rural në territorin e Komunës së Skenderajt.
3. Kujdeset për organizimin e seminareve dhe këshillave të ndryshme me fermer me qëllim të formësimit profesional të tyre.
4. Bënë inkurajimin e fermerëve për të investuar në rritjen e kapaciteteve bujqësore (bimëve, blegtorisë, bletarisë).
5. Mbanë evidencë në koordinim me institucionet tjera për të arritur vetëdijesimin për potencialin e zhvillimit ekonomik që ka bujqësia, duke ndikuar në zvogëlimin e papunësisë, sigurimin e ushqimit, sigurimin e lëndëve të para për zhvillimin e industrisë ushqimore.

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural

6. Analizon potencialin e fermerëve, nevojat dhe mundësitë e zhvillimit të tyre, rekomandon masa adekuate dhe hulumton mundësi për mbështetje administrative, profesionale dhe materiale të tyre.

7. Hulumton mundësitë për sigurimin e tregut për prodhimtarinë bujqësore të fermerëve.
8. Përkujdeset që të siguroj që toka bujqësore të shfrytëzohet për prodhimtari të qëndrueshme bujqësore.
9. Ndërmerr masa për mbrojtjen e prodhimtarisë bujqësore nga fatkeqësitë natyrore (vërshimet, breshëri, zjarri, pandemitë). Formon komisionet e parandalimit dhe vlerësimit të dëmeve nën autorizimet e Kryetarit të Komunës.
10. Rregullon dhe mbikëqyrë mbarështimin e qenëve endacak, aktivitetet rreth zhdukjes së insekteve të dëmshme, sëmundjeve të bimëve, sëmundjet e kafshëve si dhe organizimin e gjuetisë në territorin e Komunës së Skenderajt.
11. Inicon dhe koordinon veprimet me Organizata jo Qeveritare (OJQ) dhe organizata të tjera të ndryshme Qeveritare duke hartuar projekte dhe duke hulumtuar për donator në fushën e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural.
12. Në koordinim me drejtorinë e inspeksionit bënë mbrojtjen e tokave bujqësore, pyjeve, shëndetin e kafshëve si dhe mbrojtjen e resurseve të tjera natyrore.
13. Kujdeset për përmirësimin dhe zhvillimin e turizmit rural.
14. Kujdeset dhe merr masa për mbrojtjen e tokës bujqësore nga erozioni.
15. Përcjell, identifikon dhe parandalon përhapjen e makro dhe mikroorganizmave dëmtues për bimë dhe produkte bimore më qëllim të ç'rrenjosjes së tyre.
16. Kujdeset për parandalimin e sëmundjeve të kafshëve dhe ruajtjes së shëndetit të tyre.
17. Hulumton dhe siguron subvencione për prodhuesit bujqësor dhe stimulon ruajtjen dhe mbarështimin e bagëtive për kultivuesit e tyre.
18. Bënë inventarizimin dhe regjistrimin e sipërfaqeve dhe të popullatave të faunës së egër dhe të gjuetisë në periudha periodike jo më të gjata se dy (2) vjeçare, në bashkëpunim me shoqatat e gjuetarëve dhe Organizata jo Qeveritare (OJQ).

19. Përcakton kriteret për evidentimin dhe regjistrimin e shoqërive bletare dhe mënyrën e transportimit të tyre dhe koordinon punët me Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), duke krijuar kushte dhe projekte të cilat mbështesin këtë sektor prodhues dhe të rëndësishëm në fushën e industrisë ushqimore.
20. Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, përcjell dhe informon prodhuesit e drithërave të bardha për kushtet e korrje-shirjes, si dhe rekomandon kriteret për autokombajnatinë sezonin e korrje-shirjes.
21. Përpilon dhe harton të gjitha propozim-vendimet dhe propozim-rregulloret si dhe aktet tjera juridike nënligjore për miratim në funksion të fushë-veprimtarisë së drejtorisë.
22. Ushtron dhe punë tjera administrative dhe funksionale të planifikuara me Ligje të veçanta dhe me akte nënligjore qendrore apo komunale si dhe me vendime apo urdhëresa të Kryetarit të Komunës, të cilit edhe i raporton dhe i përgjigjet për punën e tij si drejtor.

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural

PLANI I PUNËS

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL VITI (2026)

Aktivitetet që do të zbatohen gjatë vitit 2026:

1. Monitorimi i mbjellave pranverore, vjeshtore;
2. Mbikëqyrja e menaxhimit të vendgjuetisë “Drenica”.
3. Monitorimi i grantëve të realizuara nga Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe donatorët;
4. Organizimi i trajnimeve për fermer;
5. Implementimi i projektit për këshillime me fermer si dhe pjesëmarrja në komisione të ndryshme;
6. Ofrimi i këshillave të fermerëve për krasitje në plantacionet ekzistuese, dhënia e këshillave për mbrojtjen e pemëve nga dëmtuesit dhe sugjerimi rreth mënyrës së mirëmbajtjes së pemishteve nga ana e fermerëve;
7. Ofrimi i informacioneve rreth granteve për mbështetjen e fermerëve nga MBPZHR;
8. Ndarja e granteve për fermerët e Skenderaj nga DBPZHR për vitin 2026;
9. Pranimi i aplikacioneve për bujqit për subvencione nga MBPZHR;
10. Përcjellja e terrenit dhe këshilla për zhvillimin e kulturave të mbjella në vjeshtë dhe pranverë;
11. Përgatitja e planit për fushatën e korrje-shirjeve në Komunën e Skenderajt;
12. Monitorimi i punës së autokombajnave në terren;
13. Organizimi i takimeve me fermerët e perimekulturës, blegtor, perimtari dhe bletar.

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural

14. Plani i mbjelljeve vjeshtore në Komunën e Skenderajt;

15. Organizimi i trajnimeve me bujqit për mundësinë e rritjes së rendimentit tek kulturat lavërtare si dhe masat agroteknike;

Me këtë plan të punës DBPZHR synon që të ofrojë ndihmë dhe ekspertizë për fermerët dhe qytetarët në këto fusha:

- Subvencione në mjete të punës dhe mekanizëm bujqësor për fermer.
- Trajnime dhe këshilla për fermer.
- Subvencionimi i perimtarisë, bletarisë, blegtorisë dhe sektorëve të tjerë të bujqësisë.
- Këshillimi dhe inkurajimi i fermerëve për aplikim për grante që ofrohen nga MBPZHR.
- Trajtimi human i qenëve endacak.
- Mbikëqyrja e menaxhimit të vendgjuesisë “Drenica” në Skenderaj.